



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË**

RREGULLORE E REVISTËS SHKENCORE

“Studime Juridike”

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

PËRMBAJTJA

Neni 1 Baza ligjore	3
Neni 2 Objektivat e rregullores	3
Neni 3 Natyra dhe periodiciteti i Revistës	3
Neni 4 Qëllimi i Revistës	3
Neni 5 Veprimtaria dhe organet drejtuese	3
Neni 6 Kompetencat e Bordit Editorial dhe Sekretariatit teknik	4
Neni 7 Përmbajtja dhe struktura e Revistës	5
Neni 8 Kriteret teknike të paraqitjes së artikujve shkencore	5
Neni 9 Metodologjia e citimeve (referimeve).....	6
Neni 10 Kushtet për refuzimin e artikullit shkencor.....	6
Neni 11 Procedura e dërgimit të artikullit për botim	7
Neni 12 Procedura e vlerësimit të punimit	7
Neni 13 Rezultatet e procesit të vlerësimit	7
Neni 14 Autorësia dhe e drejta e pronësisë.....	8
Neni 15 Financimi i revistës	8
Neni 16 Procedura e kontrollit të plagjiaturës	8
ANEKS “Udhëzues për autorët”	10

Neni 1

Baza ligjore

- 1.1 Rregullorja e Revistës Shkencore “Studime Juridike”, bazohet në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës.

Neni 2

Objektivat e rregullores

- 2.1 Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë rregullat kryesore që lidhen me procedurat e pranimit për botim, vlerësimin shkencor, kontrollin të plagjiaturës, shkrimit dhe publikimit të artikujve shkencorë në të.

Neni 3

Natyra dhe periodiciteti i Revistës

- 3.1 Revista “Studime Juridike” është revistë shkencore që botohet nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
- 3.2 Revista “Studime Juridike” është revistë periodike e cila botohet jo më pak se dy herë në vit, një numër në muajin qershor të çdo viti dhe numri i dytë në muajin dhjetor të çdo viti.
- 3.3 Revista “Studime Juridike” botohet në gjuhën shqipe. Artikujt e botuar në gjuhën shqipe duhet të përmbajnë një abstrakt në gjuhën angleze. Artikujt e autorëve të huaj botohen në gjuhën angleze dhe duhet të përmbajnë një abstrakt në gjuhën shqipe.
- 3.4 Revista identifikohet me një ISSN të vlefshme.

Neni 4

Qëllimi i Revistës

- 4.1 Revista “Studime Juridike”, shërben për të pasqyruar zhvillimet më të fundit doktrinale, kërkimore-shkencore të kësaj njësie në nënfushën e shkencave juridike, fusha shkencë sociale dhe humanitare. Ato mund të shërbejnë edhe si pjesë e bibliografisë për lëndët mësimore që jepen në njësitë e Universitetit të Tiranës.

Neni 5

Veprimtaria dhe organet drejtuese

- 5.1 Revista e ushtron veprimtarinë e saj përmes mbledhjeve të Bordit Editorial, i cili mbledhet të paktën 1-2 herë për çdo numër që botohet, si dhe Sekretariatit Teknik Shkencor.
- 5.2 Revista mund të ketë edhe një Bord Honorifik, i cili përbëhet nga profesorë vendas dhe të huaj, me kontribut të spikatur në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe botuese.
- 5.3 Bordi Editorial është një organ vendimmarrës që përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe jo më shumë se 15, me mandat 5 vjeçar me të drejtë për tu rizgjedhur.
- 5.4 Anëtarët e Bordit zgjidhen nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë dhe të kategorisë “Profesor”. Ato zgjidhen nga departamentet dhe i përcillen drejtuesit të njësisë kryesore. Anëtarët e Bordit duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që të përfshihen të gjitha departamentet e fakultetit. Kryetari i Bordit dhe anëtar *ex officio*, është zëvendës dekan i fakultetit që mbulon fushën e kërkimit shkencor.
- 5.5 Anëtarë të Bordit mund të jenë dhe pedagogë të huaj, të cilët janë bashkëpunëtorë shkencorë të fakultetit. Numri i tyre nuk mund të jetë më shumë se ½ e anëtarëve të Bordit.
- 5.6 Sekretariati teknik i revistës, përbëhet nga 3 anëtarë, ku një prej tyre është përfaqësues nga personeli akademik, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik dhe një përfaqësues nga personeli administrativ. Anëtarët e Sekretariatit emërohen nga Bordi i Revistës dhe kanë një mandat 5 vjeçar, me të drejtë për tu rizgjedhur.
- 5.7 Përfaqësuesit e personelit akademik në sekretariatit shkencor duhet të kenë gradën shkencore Doktor (Dr) si dhe të kenë eksperiencë në fushën e publikimeve shkencore.
- 5.8 Anëtarët e Bordit Editorial dhe të Sekretariatit Teknik përfitojnë një shtesë page për veprimtarinë që kryejnë. Masa e shtesës propozohet nga Dekani dhe miratohet nga Bordi i Administrimit të UT-së, sipas parashikimeve të nenit 86 të Rregullores së UT-së.

Neni 6

Kompetencat e Bordit Editorial dhe Sekretariatit teknik

- 6.1 Anëtarët e Bordit Editorial të Revistës kanë këto të drejta dhe detyrime:
 - a) Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit duke siguruar jo vetëm pjesëmarrjen por edhe aktivizimin e plotë në dhënien e mendimeve dhe leximin e materialeve që do të seleksionohen për botim. Mungesa e pajustificuar më shumë se në dy mbledhje radhazi sjell zëvendësimin e tyre me një kandidat tjetër;
 - b) Të diskutojnë për artikujt duke caktuar të paktën dy vlerësues shkencorë për çdo artikull, në varësi të fushave ku është specializuar secili vlerësues, duke mundësuar dhe redaktimin shkencor të materialeve të sjella për botim;
 - c) Merr vendim për artikujt që pranohen për botim.
- 6.2 Sekretariati teknik i revistës ka këto të drejta dhe detyra:
 - a) Të grumbullojë artikujt;
 - b) Në bashkëpunim me Kryetarin e Bordit të caktojë takimet dhe mbledhjet e Bordit të revistës, duke bërë njoftimet përkatëse të paktën tre javë para;
 - c) Të dërgojë kopje elektronike dhe fizike të të gjithë artikujve tek çdo anëtar i Bordit të paktën dy javë para mbledhjes së tij;
 - d) Në bashkëpunim me Kryetarin e Bordit të caktojë dy vlerësues shkencorë për çdo artikull, sipas fushave që mbulon secili vlerësues;
 - e) Të mbajë procesverbalet e mbledhjeve të Bordit dhe të përpilojë aktet dhe vendimet e marra prej tij;

- f) Të ketë komunikim të rregullt me çdo autor për vendimet e Bordit, duke ruajtur konfidencialitetin e diskutimeve dhe të debateve në mbledhje. Shkelja e këtij rregulli sjell si sanksion vërejtje me paralajmërim dhe nëse përsëritet largim nga detyra në Sekretariatin teknik;
- g) Të mbajë kontakte të rregullta me shtëpinë botuese, përkthyesin, redaktorin gjuhësor, specialistin e faqesjes, etj duke respektuar rregullat dhe procedurat publike në bashkëpunim edhe me Zyrën e Financave;
- h) Të raportoje për tematiken e ezauruar në numrat e mëparshëm, që të mos të ketë përsëritje të temave e problematikës së trajtuar në numrat pasardhës.
- i) Të dërgojë versionin e fundit të faqesur të Revistës për anëtarët e Bordit para se të botohet.

Neni 7

Përmbajtja dhe struktura e Revistës

- 7.1 Përmbajtja e Revistës duhet të ketë përgjithësisht të gjithë elementët e një Reviste Shkencore, si përsa i përket formës, ashtu edhe përmbajtjes.
- 7.2 Revista është e strukturuar në 3 seksione: (I) Artikuj kërkimorë-shkencorë; (II) Artikuj vlerësues; dhe (III) Jurisprudencë.
- 7.3 Çdo artikull apo material duhet të strukturojë qartë: hyrjen ku shpjegohet qëllimi i temës, përshkrimin e ndarë në nënçështje, konkluzionet dhe bibliografinë.
- 7.4 Çdo artikull që botohet në Revistën “Studime Juridike” nuk duhet të jetë botuar më parë në libër, tekst, revistë apo botim tjetër, si dhe nuk duhet të botohet në të ardhmen në ndonjë revistë tjetër shkencore në gjuhën shqipe.
- 7.5 Me qëllim që të krijojë mundësinë e botimeve për sa më shumë autorë, duhet të zbatohet rregulli që një autor nuk mund të publikojë artikull kërkimor-shkencor në dy numra të njëpasnjëshëm të revistës.

Neni 8

Kriteret teknike të paraqitjes së artikujve shkencore

- 8.1 Artikulli kërkimor-shkencor duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.
- 8.2 Artikujt kërkimorë-shkencorë duhet të paraqiten si artikuj jo më shumë se 20 faqe dhe jo më pak se 10 faqe, ndërsa artikujt vlerësues duhet të përmbajnë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 10 faqe. Në “Udhëzuesin për autorët” bashkëngjitur kësaj Rregulloreje përcaktohen kërkesat teknike që kanë të bëjnë me shkrimin dhe formën e materialeve të dorëzuara për botim.
- 8.3 Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman 12” me “Hapësirë 1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”.
- 8.4 Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me gjerat “ë” dhe “ç”.

8.5 Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

- a) Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.
- b) Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe në fund të emrit të vendoset një referencë (footnote), ku të jepet pozicioni dhe profesional aktual i tij/saj. Renditja e autorëve duhet të përcaktohet në bazë të kontributit të tyre në rezultatin përfundimtar dhe nëse roli i secilit autor është i njëjtë, ata renditen në rend alfabetik. Vendimi i pozicionit të emrave të autorëve është në marrëveshjen e tyre dhe jo të revistës. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa tituj dhe në nënçështje në varësi të tematikës që shtron.
- c) Çështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, porë në këndvështrimin e interesave të Fakultetit të Drejtësisë dhe të praktikës gjyqësore.
- d) Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italic”, “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data-Muaji-Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1.1, 2.1, 3.1 etj.
- e) Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.
- f) Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 15 referenca, vepra dhe vendime gjyqësore.

Neni 9

Metodologjia e citimeve (referimeve)

Të gjitha punimet e revistës duhet të respektojnë stilin (metodologjinë) e citimeve OSCOLA.

Neni 10

Kushtet për refuzimin e artikullit shkencor

10.1 Një artikull shkencor nuk do të pranohet nëse nuk plotëson një prej kushteve:

- a) Formati nuk është bazuar në modelin e revistës;
- b) Tema nuk është e lidhur me përmbajtjen e revistës;
- c) Gjuha nuk është e përshtatshme;
- d) Përmbajtja nuk është siç përshkruhet në udhëzues;
- e) Autori (ët) nuk dorëzoi dorëshkrimin në përputhje me afatin, (abstrakt, artikullin e plotë ose rishikim pas rishikimit të vlerësuesve);
- f) Referencat nuk janë përfshirë në tekst;
- g) Referencat janë të limituara, shumë shkurt ose shumë të vjetra;
- h) Tabelat dhe figurat nuk janë të lexueshme;

- i) Artikulli është i pastrukturuar;
- j) Pjesë ose artikulli i plotë nuk është konsideruar original (bazuar në kontrollin e plagjiarizmit);
- k) Artikulli nuk ka respektuar stilin e citimeve OSCOLA.

Në rast të mungesës, të paktën e një prej tyre, artikulli nuk mund të pranohet dhe do të konsiderohet si i pa përfunduar.

Neni 11

Procedura e dërgimit të artikullit për botim

- 11.1 Artikulli duhet të dorëzohet online nëpërmjet adresës elektronike të revistës. Artikujt duhen dorëzuar jo më pak në 1 muaj para dërgimit të Revistës për botim.
- 11.2 Shqyrtimi paraprak i artikujve bëhet nga Bordi Shkencor, i cili për çdo artikull të dorëzuar cakton dy vlerësues shkencorë.
- 11.3 Bordi vendos përfundimisht për pranimin ose jo për botim të artikujve, pas marrjes dhe shqyrtimit të mendimeve të vlerësuesve shkencorë.

Neni 12

Procedura e vlerësimit të punimit

- 12.1 Artikujt e revistës do të jenë pjesë e një procedure të pavarur të shqyrtimit "blind peer review". Secili artikull ka të paktën dy vlerësues shkencorë. Ky proces do realizohet duke u bazuar në parimin e pavarësisë së vlerësuesve dhe anonimatit të autorëve. Vlerësuesit duhet të jenë ekspertë në fushën e punimit. Procesi i vlerësimit merr parasysh faktorë të tillë si rëndësia, rezultatet, analiza, origjinaliteti, lexueshmëria dhe cilësia e gjuhës. Rezultatet e mundshme të procesit të vlerësimit përfshijnë pranimin, pranimin pas rishikimeve ose refuzimin e punimit.
- 12.2 Autori do të informohet për rezultatin e procesit të rishikimit nga Bordi Editorial, përmes Sekretariatit teknik. Pas procesit të suksesshëm të vlerësimit, artikujt i nënshtrohen korrigjimit, përgatitjes për shtypje dhe miratimit përfundimtar të autorit. Publikimi i artikujve nuk ka përfitime financiare. Autorët botojnë artikujt e tyre falas (pa tarifa botimi).

Neni 13

Rezultatet e procesit të vlerësimit

- 13.1 Bordi Editorial duhet t'u përmbahet në mënyrë rigoroze vlerësimit të kritereve teknike të përcaktuara në këtë rregullore.

- 13.2** Bordi dërgon raportin anonim të vlerësimit tek autori dhe një letër me gjykimet përfundimtare për artikullin.
- 13.3** Vendimi që merret si rezultat i procesit të vlerësimit të artikullit mund të konsistojë në:
- a) Artikulli pranohet për botim pa ndonjë ndryshim të mëtejshëm të kërkuar nga autorët.
 - b) Artikulli pranohet për publikim me disa rishikime të vogla nga autori (ët).
 - c) Artikulli pranohet për publikim me disa rishikime të mëdha nga autori (ët).
 - d) Artikulli refuzohet në bazë të "Kushteve për mospranimin e punimeve".
 - e) Artikulli refuzohet sepse autori (ët) nuk i është përgjigjur bordit pas dërgimit të komenteve, brenda afateve të caktuara nga Bordi.

Neni 14

Autorësia dhe e drejta e pronësisë

- 14.1** Artikulli shkencor nuk duhet të jetë i botuar dhe bërë publik më parë në ndonjë formë apo mënyrë tjetër dhe nuk mund të ribotohet pas botimit të tij në revistën "Studime juridike", në një revistë tjetër në të njejtën gjuhë. Ribotimi në gjuhë të huaj lejohet, me kushtet që të citohet që është botuar për herë të parë në Revistën Studime Juridike dhe vetëm në ato raste të veçanta kur artikulli është i një niveli mjaft të kërkuar dhe sjell risi në fushën përkatëse.
- 14.2** Revista përfaqëson një vepër kolektive të botuar të FD-së, e cila respekton të drejtat intelektuale jopasurore të autorëve të shkrimeve.
- 14.3** Pas botimit të shkrimeve dhe artikujve në Revistën "Studime Juridike" çdo e drejtë ekonomike që lidhet me to i kalon FD-së në mënyrë të përhershme, sepse të drejtën e pronësisë mbi revistën dhe materialet e botuar në numrat e saj e gëzon Fakulteti.

Neni 15

Financimi i revistës

- 15.1** Revista "Studime Juridike" botohet nga Fakulteti i Drejtësisë me fondet e brëndshme të tij, që burojnë nga buxheti i shtetit, me të ardhurat e grumbulluara nga shitjet dhe abonimet, si dhe donacionet e ofruara nga donatorë vendas dhe të huaj.
- 15.2** 5 kopje të botimit i dhurohen falas Bibliotekës Kombëtare, 5 kopje bibliotekës së Fakultetit dhe nga një kopje secilit autor.
- 15.3** Bordi Editorial i Revistës mund të vendosë për dhurimin e Revistës edhe institucioneve të tjera partnere.

Neni 16

Procedura e kontrollit të plagjiaturës

- 16.1** Revista synon të publikojë artikuj që ndjekin strukturën e përcaktuar në udhëzuesin për autorët. Plagjiatura në çfarëdo forme nuk tolerohet. Autorët që paraqesin artikuj deklarojnë se përmbajtja e dorëshkrimeve të tyre është origjinale. Dorëzimi i një punimi nënkupton që autorët marrin përgjegjësinë e plotë për respektimin e këtyre kritereve. Revista nuk do të mbajë përgjegjësi në rast të ankesave ose kërkesave për kompensime financiare nga palët e treta.
- 16.2** Revista respekton rregullat e vendosur nga UT për kontrollin e plagjiaturës.

ANEKS

“Udhëzues për autorët”

I. Vlerësimi i artikujve dhe aprovimi i tyre

1. Artikujt shkencorë i drejtohen Revistës Shkencore “Revista Juridike”, në adresën elektronike revista.juridike@fdut.edu.al, shoqëruar me adresën e emailit të autorit, me të cilën do të lidhet në vazhdim Bordi Shkencor.
2. Në rastin e bashkëautorësisë, plotësohet një formular nga autorët e tjerë të cilët japin dakordësinë për ushtrimin e kompetencave nga njëri autor.
3. Artikujt i nënshtrohen vlerësimit të Bordit Shkencor, i cili miraton botimin pas ndryshimeve eventuale nga ana e autorit.
4. Pasi materiali kthehet për rregullime ai ridërgohet në formën e tij përfundimtare në adresën elektronike të revistës.

II. Struktura dhe përmbajtja e artikujve shkencorë

1. Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.
2. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 10 faqe dhe jo më shumë se 20 faqe kompjuterike, që konvertohen në po aq faqe reviste.
3. Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman 12” me “Hapësirë1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”.
4. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.
5. Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:
 - a) Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere;
 - b) Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe në fund të emrit të vendoset një referencë (footnote), ku të jepet detyra profesionale aktuale e autorit. Renditja e autorëve duhet të përcaktohet në bazë të kontributit të tyre në rezultatin përfundimtar dhe nëse roli i secilit autor është i njëjtë, ata renditen në rend alfabetik. Vendimi i renditjes së emrave të autorëve është në marrëveshjen e tyre dhe jo të revistës;
 - c) Poshtë titullit të artikullit dhe emrit të autorit duhet të jepet Abstrakti. Abstrakti duhet të jetë max. 300 fjalë, në gjuhën shqipe dhe në anglisht, me formatin e shkrimit Times New Roman 12, hapësira ndërmjet rreshtave 1.15. Abstrakti duhet të theksojë shkurtimisht qëllimin e kërkimit, metodat, rezultatet kryesore dhe përfundimet. Abstrakti jep dhe një përmbledhje të përmbajtjes së artikullit dhe është një lloj promovimi për artikullin në mënyrë që të tërheqë interesin e lexuesit për tërë artikullin. Duhet të shmangen referencat, citimet, vitet, shënimet në fund, shkurtimet, simbolet e vogla dhe numrat, tabelat ose figurat në abstrakt. Në fund të abstraktit jepen fjalët kyçe. Fjalët kyçe me formatin e shkrimit duhet të jenë Times New Roman 12, hapësira ndërmjet rreshtave 1.15

- (5 - 7 fjalë). Fjalët kyçe janë fjalët që përdoren më shpesh përmes artikullit që ndihmojnë kërkimin nëpërmjet internetit të vendndodhjes dhe gjetjes së artikullit;
- d) Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa çështje dhe nënçështje në varësi të tematikës që shtron;
 - e) Çështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij, parë në këndvështrimin e interesave të Fakultetit të Drejtësisë dhe të praktikës gjyqësore;
 - f) Të gjithë titujt e çështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data-Muaji-Viti. Titujt e çështjeve do të paraprihen nga numrat 1, 2, 3 etj.;
 - g) Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me shkrim “Italic” dhe “Times New Roman 12” dhe duhet të paraprihen nga numrat 1.1, 1.2, 1.3 etj.;
 - h) Në fund të artikullit duhet të vendoset një çështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet;
 - i) Konkluzionet duhet të jenë në formatin “Times New Roman 12”, me hapësirë midis rreshtave 1.15, “Justify”. Përfundimi duhet të sigurojë një sintezë të kontributeve kryesore të artikullit, rëndësinë e punës për industrinë dhe/ose shoqërinë dhe të sugjerojë kufizimet e mundshme dhe zgjerimin e kërkimit. Konkluzionet janë pjesa që lexuesi do të mbajë në mendje, prandaj pa të, punimi nuk është përfunduar. Në përfundim ju duhet të përmbledhni gjetjet dhe temat më të rëndësishme të analizuara në artikull. Konkluzioni duhet të jetë konciz dhe jo shumë i gjatë. Një mënyrë e mirë për të shkruar gjetjet është kthimi në qëllimin e artikullit tuaj, jo domosdoshmërisht duke përdorur të njëjtat fjalë dhe lidhjen e pyetjeve kërkimore që keni kërkuar, me konkluzionet që keni arritur. Konkluzionet janë mundësia e fundit për të treguar kufizimet e rezultateve të paraqitura pa theksuar gabimet ose gjykuar punën tuaj. Nuk duhen ndarë diskutimet dhe rekomandimet nga përfundimet;
 - j) Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 15 referenca, vepra dhe vendime gjyqësore. Renditja e referencave bëhet sipas rendit alfabetik, me shkrimin “Times New Roman 12”, “Hapësirë 1”, jo bold.

III. Footnote dhe Referencat

1. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që është studiuar dhe referuar. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë, duhet vendosur në formë citati, në thonjëza. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: titullin e veprës, autorin, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marre citati. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë. Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me “Justify”.
2. Shënimet në fund (footnote) duhet të përdoren vetëm kur është e nevojshme dhe duhet të numërohen në të gjithë artikullin. Shënimet në footnote nuk janë të lejuara në abstrakt dhe në listën e referencave.
3. Shënimet në footnote dhe bibliografia duhet të realizohen sipas stilit (metodologjia) të citimeve OSCOLA, me rregullat e të cilit mund të konsultoheni në webfaqen: <https://libguides.city.ac.uk/citingandreferencinglaw/guidance>.